

Pranuar - Primiljeno Më/Dana 05.07.2024			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vendi Vestisnoe

**MARRËVESHJE E FINANCIMIT (NDËRMJET PROGRAMIT TË KOMBEVE TË  
BASHKUARA PËR ZHVILLIM DHE KOMUNËS SË VITISË**

DUKE QENË se Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (në tekstin e mëtejme "UNDP") dhe Komuna e Vitisë (në tekstin e mëtejme "Komuna") kanë rënë dakord të bashkëpunojnë në zbatimin e projektit (në tekstin e mëtejme "Projekti"), në siç është përshkruar në dokumentin e Projektit Nr. 01002704 Programi për Qëndrueshmëri Ekonomike -Promovimi i Zhvillimit të Sektorit Privat dhe i është dorëzuar Komunës për informim.

DUKE QENË se Komuna ka informuar UNDP-në për gatishmërinë e saj për të kontribuar me fonde (në tekstin e mëtejme "kontributi") për UNDP-në, në bazë të ndarjes së kostos, për të rritur burimet financiare të disponueshme për projektin.

DUKE QENË se UNDP-ja do të caktojë një Partner Zbatues për zbatimin e çdo projekti të financuar nga kontributi (më tej referuar si "Partneri Zbatues") PRANDAJ, UNDP dhe Komuna bien dakord si më poshtë:

**Neni I**

1. Komuna, sipas mënyrës së referuar në paragrafin 2 të këtij neni, vë në dispozicion të UNDP-së kontributin prej 100.000 Euro [Njëqind mijë euro].

Komuna, në përputhje me afatet e pagesave të përcaktuara më poshtë, depoziton kontributin në:

Përfituesi:	UNDP Kosovë
Emri i bankës:	Raiffeisen Bank
Adresa e bankës:	Robert Doll 99, Prishtina
Nr. i llogarisë:	1501090002960222
IBAN:	XK051501090002960222
SWIFT adresa:	RBKOKPR

**Data e pagesës**

**Shuma (monedha e deklaruar)**

(a) Korrik 2024	50,000 Euro
(b) Tetor 2024	50,000 Euro

2. Kur të paguhet Kontributi, Komuna do ta informojë UNDP-në me e-mail me informacion të dërgesave në adresën: [contributions@undp.org](mailto:contributions@undp.org), duke dhënë informacionin e mëposhtëm: Emri i Komunës, UNDP, Programit për Qëndrueshmëri Ekonomike-Promovimi i Zhvillimit të Sektorit Privat 01002704. Ky informacion duhet gjithashtu të përfshihet në këshilla bankare të remitancave kur fondet iu dërgohen UNDP-së.

3. Plani i mësipërm i pagesave merr parasysh kërkesën që kontributet të paguhen përpara zbatimit të aktiviteteve të planifikuara. Kjo mund të ndryshohet për të qenë në përputhje me ecurinë e realizimit të projektit. UNDP nuk do të absorbojë asnjë humbje (duke përfshirë por pa u kufizuar në luhatjet e këmbimeve) në kuadër të Projektit. Palët pranojnë dhe janë dakord që të gjitha humbjet do t'i ngarkohen Projektit.

4. *Vlera e pagesës, nëse bëhet në një monedhë të ndryshme nga dollarët amerikanë, do të përcaktohet duke aplikuar normën operative të këmbimit të Kombeve të Bashkuara në fuqi në datën e pagesës. Nëse do të ketë një ndryshim në normën operative të këmbimit të Kombeve të Bashkuara para shfrytëzimit të plotë të pagesës nga UNDP, vlera e bilancit të fondeve që mbahen ende në atë kohë do të rregullohet në përputhje me rrethanat. Nëse, në një rast të tillë, regjistrohet humbje në vlerën e bilancit të fondeve, UNDP do të informojë Komunitetin me qëllim të përcaktimit nëse mund të sigurohet ndonjë financim i mëtejshëm nga Komuna. Nëse një financim i tillë i mëtejshëm nuk do të jetë i disponueshëm, asistenca që duhet t'i ofrohet projektit mund të zvogëlohet, suspendohet ose anulohet nga UNDP.*

5. Të gjitha llogaritë financiare dhe deklaratat duhet të shprehen në dollarë amerikanë.

6. UNDP mund të pranojë të dakordohet që të pranojë Kontributet në një monedhë të ndryshme nga dollarët amerikan me kusht që monedha e tillë të jetë plotësisht e konvertueshme ose e përdorshme nga UNDP dhe t'i nënshtrohet dispozitave të paragrafit 6 më lart. Çdo ndryshim në monedhën e kontributit do të bëhet vetëm në pajtim me UNDP-në.

#### **Neni II**

1. Në përputhje me vendimet dhe direktivat e Bordit Ekzekutiv të UNDP-së, të pasqyruara në Politikën e tij të Rikuperimit të Kostove nga Burimet e Tjera, Kontributi do të jetë subjekt i rikuperimit të kostos për shpenzimet e drejtpërdrejta të shkaktuara nga selia e UNDP-së dhe strukturat e zyrës së UNDP-së në ofrimin e shërbimeve të Mbështetjes së Përgjithshme të Menaxhimit (GMS). Për të mbuluar kostot e GMS, kontributi do të paguhet një tarifë të barabartë me 5 %. Për më tepër, për sa kohë që ato janë të lidhura qartë me projektet specifike, të gjitha shpenzimet e drejtpërdrejta të zbatimit, përfshirë kostot e zbatimit të partnerit, do të identifikohen në buxhetin e projektit kundrejt një vije përkatëse buxhetore dhe do të mbulohen nga projekti në përputhje me rrethanat.

2. Totali i shumave të buxhetuara për projektin, së bashku me kostot e vlerësuara të rimbursimit të shërbimeve mbështetëse përkatëse, nuk duhet të tejkalojnë resurset totale të disponueshme për projektin sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe fondet që mund të jenë në dispozicion të projektit për shpenzimet e projektit dhe për kostot e mbështetjes në kuadër të burimeve të tjera të financimit.

#### **Neni III**

1. Kontributi do të administrohet nga UNDP në përputhje me rregulloret, rregullat, politikat dhe procedurat e UNDP-së, duke zbatuar procedurat e saj normale për ekzekutimin e projekteve të saj.

2. Menaxhimi i projektit dhe shpenzimet rregullohen më anë të rregulloreve, politikave dhe procedurave të UNDP-së dhe, aty ku është e aplikueshme, rregulloret, rregullat, politikat dhe procedurat e Partnerit Zbatues.

#### **Neni IV**

1. Zbatimi i përgjegjësive të UNDP-së dhe të Partnerit Zbatues në përputhje me këtë Marrëveshje dhe dokumentin përkatës të projektit varen nga pranimi i kontributit nga UNDP në përputhje me planin e pagesave të përcaktuar në nenin I, paragrafi 2 më lart. UNDP-ja nuk do të fillojë zbatimin e aktiviteteve para se të marrë Kontributin ose këstin e parë të kontributit (cilido që është i aplikueshëm).
2. Nëse priten apo realizohen rritje të paparashikuara në shpenzime apo angazhime (qoftë për shkak të faktorëve të inflacionit, luhatjeve në kurset e këmbimit ose rrethana të paparashikuara), UNDP do t'i dorëzojë Komunës në kohë një vlerësim plotësues që tregon financimin e mëtejshëm që do të jetë i nevojshëm. Komuna do të bëjë përpjekjet e saj më të mira për t'i vënë në dispozicion UNDP-së fondet e kërkuara shtesë.
3. Nëse Kontributi i përmendur në Nenin I, paragrafi 2, më lartë, nuk janë marrë në përputhje me planin e pagesës, ose nëse financimi shtesë i kërkuar në përputhje me paragrafin 2 më lart, nuk vjen nga Komuna ose burime të tjera, ndihma që do t'i ofrohet Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje mund të reduktohet, pezullohet ose ndërpritet nga UNDP.

#### **Neni V**

Pronësia e pajisjeve, furnizimeve dhe pronave të tjera të financuara nga kontributi mbesin me UNDP -në. Çështjet që lidhen me transferimin e pronësisë nga UNDP do të përcaktohen në përputhje me politikat dhe procedurat përkatëse të UNDP-së.

#### **Neni VI**

Kontributi do të jetë subjekt vetëm i procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm të parashikuara në rregulloret financiare, rregullat, politikat dhe procedurat e UNDP-së.

#### **Neni VII**

UNDP-ja do t'i ofrojë Komunës, sipas kërkesave, raporte financiare dhe raporte të tjera të përgatitura në përputhje me procedurat e raportimit të UNDP-së.

#### **Neni VIII**

1. UNDP-ja do të njoftojë Komunën kur të gjitha aktivitetet në lidhje me Projektin të kenë përfunduar në përputhje me dokumentacionin e Projektit.
2. Pavarësisht nga përfundimi i të gjitha aktiviteteve që lidhen me projektin "Programi për Qëndrueshmëri Ekonomike - Promovimi i Zhvillimit të Sektorit Privat", UNDP do të vazhdojë të mbajë fonde të pashfrytëzuara nga kontributi derisa të gjitha angazhimet dhe detyrimet e lidhura me zbatimin e aktiviteteve të financuara nga kontributi të jenë përmbushur dhe këto aktivitete të jenë përfunduar në mënyrë të rregullt.

3. Nëse fondet e pashfrytëzuara nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur angazhimet dhe detyrimet e tilla, UNDP do ta njoftojë Komunën dhe do të konsultohet me Komunën për mënyrën në të cilën mund të përmbushen angazhimet dhe detyrimet e tilla.
4. Në rastet kur projekti përfundon në përputhje me dokumentin e projektit, çdo fond nën 5.000 euro (pesë mijë euro) që mbeten të pashpenzuara pasi të jenë përmbushur të gjitha angazhimet dhe detyrimet do të rialokohen automatikisht nga UNDP. Çdo fond prej mbi 5.000 Euro (pesë mijë Euro) që mbeten të pashpenzuar pasi të jenë përmbushur të gjitha angazhimet dhe detyrimet, do të rialokohet nga UNDP pas konsultimit me Komunën.

#### Neni IX

Palët bien dakord se është e rëndësishme të merren të gjitha masat e nevojshme për të shmangur praktikat korruptive. Për këtë qëllim, UNDP do të mirëmbajë standarde të sjelljes për performancën e stafit të saj, duke përfshirë praktikat korruptive në lidhje me dhënien dhe administrimin e kontratave, granteve ose përfitimeve të tjera, siç përcaktohet në Rregulloren e Stafit dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara, në Rregulloret dhe Rregullat Financiare të UNDP-së dhe në Manualin e Prokurimit të UNDP-së.

#### Neni X

Në përputhje me rezolutat e shumta të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë S/RES/1269 (1999), S/RES/1368 (2001), dhe S/RES/1373 (2001), si Donatori ashtu edhe UNDP-ja janë të përkushtuar për luftën ndërkombëtare kundër terrorizmit, dhe në veçanti, kundër financimit të terrorizmit. Është politika e UNDP-së që të sigurojë që asnjë nga fondet e saj të mos përdoret, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për të siguruar mbështetje për individët ose subjektet e lidhura me terrorizmin. Në përputhje me këtë politikë, UNDP merr përsipër të përdorë përpjekje të arsyeshme për t'u siguruar që asnjë nga fondet e Donatorit të parashikuara në këtë Marrëveshje nuk përdoret për të siguruar mbështetje për individët ose subjektet e lidhura me terrorizmin.

#### Neni XI

1. Pas konsultimeve mes dy Palëve në këtë Marrëveshje dhe më kusht që fondet nga kontributi i marrë tashmë, së bashku me fondet e tjera në dispozicion të Projektit janë të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha angazhimet dhe detyrimet e bëra në zbatimin e projektit, kjo marrëveshje mund të ndërpritet nga UNDP ose nga Komuna. Marrëveshja do të pushojë së ekzistuari tridhjetë ditë pasi njëra Palë mund të ketë njoftuar me shkrim Palën tjetër për vendimin e saj për ta ndërprerë Marrëveshjen.
2. Nëse pagesat e kontributeve të pashfrytëzuara, së bashku me fondet e tjera në dispozicion të Projektit janë të pamjaftueshme për të përmbushur angazhimet dhe detyrimet e tilla, UNDP-ja do të njoftojë dhe do të konsultohet me Komunën për mënyrën në të cilën mund të përmbushen angazhimet dhe detyrimet e tilla.
3. Pavarësisht nga ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje, UNDP do të vazhdojë t'i mbajë fondet e pashfrytëzuara derisa të gjitha angazhimet dhe detyrimet e lidhura me zbatimin e

aktiviteteve të financuara nga kontributi të jenë përmbushur dhe këto aktivitete të jenë përfunduar në mënyrë të rregullt.

4. Në rastet kur kjo marrëveshje përfundon para përfundimit të Projektit, fondet nën 5.000 Euro (pesë mijë Euro) që mbeten të pashpenzuara pasi të jenë përmbushur të gjitha angazhimet dhe detyrimet do të rialokohen automatikisht nga UNDP-ja. Çdo fond prej mbi 5.000 Euro (pesë mijë Euro) që mbeten të pashpenzuar pasi të jenë përmbushur të gjitha angazhimet dhe detyrimet, do të rialokohet nga UNDP-ja pas konsultimit me Komunën.

### Neni XII

Çdo njoftim ose korrespondencë ndërmjet Komunës dhe UNDP-së do të adresohet si vijon:

Për Komunën:

Kryetari i Komuna se Vitisë : Sokol Haliti

Adresa: Rr. 28 Nëntori, 61000 Viti

- a) Pas pranimit të fondeve, UNDP-ja do të dërgojë një dëftesë elektronike në adresën elektronike të poshtëshënuar të Komunës si konfirmim se fondet e dërguara janë pranuar nga UNDP  
Adresa elektronike: sokol.haliti@rks-gov.net
- b) Për UNDP :

Valbona Bogujevci

Ndihmëse e Përfaqësuesit të Përhershëm të UNDP-së

Adresa: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)

Rr. Zagrebi, nr.58

10000 Prishtinë

### Neni XIII

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje nga palët, në datën e nënshkrimit të fundit.


NË DËSHMI TË KËSAJ, nënshkruesit, duke qenë të autorizuar në mënyrë të rregullt, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze në dy kopje. Versioni në anglisht do të mbizotërojë për qëllime interpretimi në rastet e mospërputhjeve.

Për Komunën:

  
  
Sokol Haliti  
Kryetar  
Komuna e Vitisë

05 korrik 2024

Për Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim:

  
Nuno Queiros  
Përfaqësues i Përhershëm  
UNDP

05 korrik 2024